



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr.142, datë 27.11.2020

**PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS
KANALIZIME FIER SH.A.**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 39**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 42**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 27.11.2020 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësajllës Kanalizime Fier sh. a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

Vëren se:

Shoqëria "Ujësajllës Kanalizime Fier" (**UK Fier**) me shkresë nr. 136 prot. datë 18.02.2020, me lëndë "Kërkesë për unifikim tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave

të ndotura" ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tre kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe Vendimin nr. 40.

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifën fikse të shoqërisë UK Fier në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me Vendimin 90 datë 28.07.2020 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Fier për unifikimin tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM nr. 63 dt. 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.”
2. Ujësjetës Kanalizime Fier në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU me shkresë nr.136 prot. datë 18.02.2020 “*Kërkesë për unifikim tarifash për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura*” propozon ndryshim të nivelit tarifor për të tre kategoritë e konsumatorëve sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me Tarifat Aktuale dhe të Propozuara nga Shoqëria sipas Kategorisë së Konsumatorëve

Kategoria e Klientëve	Tarifat aktuale							Tarifat e propozuara
	Frakull	Fier, Topojë, Qendër	Cakran	Dermenas	Mbrostar	Portëz Levan	Libofsh	E Gjithë Zona e Shërbimit
A. Tarifë Volumetrike për Furnizimin me Ujë	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>
1.Klientë Familjarë	45	52	50	42	50	45	40	52
2.Klientë Publikë	105	105	105	105	105	105	105	105
3.Klientë Privatë	125	125	50	125	60	125	70	125
4.Klientë të Veçantë* (Industri)	-	70	-	-	-	-	-	-
B. Tarifë Volumetrike për Shërbimin e Kanalizimeve	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>	<i>lek/m³</i>
1.Klientë Familjarë	13	13	-	13	-	-	-	13
2.Klientë Publikë	18	18	18	18	18	18	18	18
3.Klientë Privatë	20	20	-	0	-	-	-	20
4.Klientë të Veçantë* (Industri)	-	20	-	-	-	-	-	-
C. Tarifë fikse shërbimi	<i>lek/muaj /lidhje</i>	<i>lek/muaj /lidhje</i>	<i>lek/muaj /lidhje</i>	<i>lek/muaj /lidhje</i>	<i>lek/muaj /lidhje</i>	<i>lek/muaj /lidhje</i>	<i>lek/muaj /lidhje</i>	<i>lek/muaj /lidhje</i>
1.Klientë Familjarë	200	200	-	-	-	-	-	200
2.Klientë Publikë	200	200	-	-	-	-	-	200
3.Klientë Privatë	200	200	-	-	-	-	-	200
D. Tarifë shitje uji me shumicë Komuna Portëz (Fshati Plyk) 26 lek/m³**								-

*Te kategoria Klientë të Veçantë janë TEC Fier dhe Uzina përpunimit të naftës të cilët janë trajtuar me tarifa të ndryshme nga kategoria klientë privat, sipas Vendimit Nr.9 datë 21.04.2014. Prej 4 vitesh këto dy biznese kanë gjetur burime alternative për furnizimin me ujë dhe shoqëria UK Fier nuk u ofron shërbim.

**Tarifë shitje uji me shumicë nuk do të aplikohet më duke qenë se këtë fshat e administrojnë vetë UK Fier që nga riorganizimi.

3. Në aplikimin aktual, duke marrë si referencë vitin e mbyllur 2019 për të cilin shoqëria ka aplikuar tarifatat për secilën zonë të shërbimit, referuar tarifave të reja të propozuara shoqëria ka përcaktuar edhe objektivat që do realizohen në vitin e ardhshëm. Treguesit Kryesorë të Performancës Para riorganizimit dhe Objektivat për Vitin 2019 dhe Vitin 2020 jepen në tabelën e mëposhtme.

Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Shoqërisë për vitet 2019-2020

Treguesit e Performancës	Njësia e matjes	Treguesit e Performancës sipas Shoqërisë		
		Para riorganizimit	Viti 2019	Viti 2020
1.Mbulimi i Kostove O&M	%	121	90	91
2.Mbulimi i Kostove Totale	%	93	75	76
3.Uji Pa të Ardhura	%	61.3	72.3	72
4.Mbulimi me Ujë	%	92	63.2	65
5.Mbulimi me KUN	%	62	48	48
6.Niveli i Matjes	%	55	65	65
7.Norma e Arkëtimit Korrente	%	76	83	84
8.Vazhdimësia e FU	orë/ditë	20.26	20	20
9.Efiçenca e Stafit UK	staf/1000 lidhje UK	6.37	6.26	6.26

4. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:
- Për arsye të riorganizimit në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".
 - Aplikon për nivel të ri tarifor vetëm për zonat e shtuara në kuadër të riorganizimit.
 - Aplikon për të njëjtin nivel tarifor që ka zona ekzistuese duke siguruar unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimi.
 - Nevoja për përballimin e kostove të shtuara si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit.

Pas ndarjes së re administrative disa nga treguesit e performancës si Mbulimi i Kostove O&M dhe i Kostove Totale kanë pësuar rënie krahasuar me periudhën e para riorganizimit. Po kështu edhe treguesit teknik si Uji Pa të Ardhura apo Mbulimi me Shërbimin e FU dhe KUN janë përkeqësuar dhe kanë dhënë efektet në financat e shoqërisë. Përmirësimi i tyre kërkon ndërhyrjen me investime për zgjerimin e zonës së shërbimit. Përfshirja në skemën e shërbimit të klientëve të rinj do të sjellë rritje të nivelit të faturimit e më pas rritje të të ardhurave të shoqërisë.

UK Fier synon vetëm unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit duke propozuar tarifatat që kanë zonat ekzistuese, me të cilat duke ruajtur të njëjtin nivel kostosh arrin të ketë pothuaj të njëjtin situatë financiare me një rritje prej 3% të Mbulimit të Kostove O&M.

5. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në Vendimin nr.42, ERRU ka kërkuar informacion shtesë nga UK Fier, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nga Shoqëria.
6. ERRU, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Fier të kritereve të mëposhtme:
 - a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar (**ligji nr. 9121**), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;
 - c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve” të ndryshuar (**ligji nr. 9902**);
 - d) Orientimin drejt mbulimit të kostove të Operim & Mirëmbajtjes.
 - e) Tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi **Përballueshmërinë** e tyre nga ana e konsumatorëve familjarë.
 - f) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.
 - g) Propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU e gjen të justifikuar, në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar kjo analizës tekniko ekonomike si dhe realizimit të objektivave të performancës të përcaktuara.
7. ERRU, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:
 - a) Shoqëria duhet të hartojë një Plan Biznesi (pesë vjeçar) duke marrë në konsideratë situatën aktuale të zonës së shërbimit pas riorganizimit, me objektiva dhe Plane Veprimi për realizimin e tyre.
 - b) Me qëllim arritjen e mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes shoqëria duhet të përpiqet të reduktojë humbjet dhe të përmirësojë treguesit me të gjitha kapacitetet e saj, si dhe evidentojë të gjithë klientët në zonën e shërbimit (kryesisht zona rurale e shtuar).
 - c) Të mbajë kostot me qendra kostojë për secilin shërbim me qëllim orientimin e tarifave drejt kostove respektive.
 - d) Të bëjë përpjekje për tu bërë pjesë e projekteve me qëllim investimin në zonën e shtuar për ofrimin e shërbimit cilësor dhe instalimin e matësve për të gjithë klientët.

- e) Të evidentojë në terren, kryesisht në zonën e shtuar, klientët e rinj me qëllim saktësimin maksimal të përfituesve të shërbimit.
- f) Të aplikojë për nivel të ri tarifor në vitin 2022 duke plotësuar dokumentacionin konform Metodologjisë së vendosjes së tarifave, me synimin e mbulimit të kostove O&M mbi 100% nëpërmjet përmirësimit të treguesve të punës si dhe nëpërmjet nivelit të ri tarifor.
- g) Brenda vitit 2021 të përfundojë instalimi i matësve në të gjithë klientët jo familjar.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me Vendim nr. 42, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura*" si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, "Për mbrojtjen e Konkurrencës", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 "Për mbrojtjen e Konsumatorëve", për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22 të ligjit nr.8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Fier si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas Vendimit në Zonën e Shërbimit
Tarifë Volumetrike për Furnizimin me Ujë	Lek/m³
Konsumatorë Familjarë	52
Konsumatorë Publikë	105
Konsumatorë Privatë	125
Tarifë Volumetrike për KUN*	Lek/m³
Konsumatorë Familjarë	13
Konsumatorë Publikë	18
Konsumatorë Privatë	20
Tarifë Fikse	Lek/muaj/lidhje
Konsumatorë Familjarë	200
Konsumatorë Publik	200
Konsumatorë Privat	200

* Tarifat e KUN do të zbatohen vetëm në ato pjesë të zonës së shërbimit ku ofrohet ky shërbim.

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2021 për UK Fier do të jenë:

Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Niveli i Objektivit për Vitin 2021 të Përcaktuar nga ERRU
Mbulimi i Kostove O&M	%	94
Mbulimi i Kostove Totale	%	79
Uji Pa të Ardhura	%	69
Mbulimi me Ujë	%	66
Mbulimi me KUN	%	48
Niveli i Matjes	%	70
Norma e Arkëtimit Korrente	%	85
Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	Orë/ditë	21
Efiçenca e Stafit	Staf/1000 lidhje	6.26

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Fier sh. a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.
4. Lidhjen e kontratës me UK Fier brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4 të nenit 22 të ligjit nr. 8102.
5. Vendimi nr. 9 datë 21.04.2014 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për shoqërinë UK Fier Sh. a” shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi me datë 01.01.2021 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani